

**VENDIM**  
**Nr. 572, datë 3.10.2018**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BRENDË PROGRAMEVE BUXHETORE TË  
BUXHETIT TË VITIT 2018, MIRATUAR PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin vitit 2018, miratuar për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, bëhet rishpërndarja e fondeve si më poshtë vijon:

a) Në programin “Programe zhvillimi”, në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme”, shtohet fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh;

b) Në programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, në zërin “Shpenzime kapitale të brendshme”, pakësohet fondi prej 800 000 000 (tetëqind milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**